



Nr. 14-376/01-0049448/25
Data 20.11.2025

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 643-25-8426-5-2-1/C578

K.K. SKENDERAJ, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Valmir Loshi B.I., Rr.20 Qeshori, ISTOG, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

048 - Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku Idriz Rreci me numër identifikues: 643-25-8426-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **048 - Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku Idriz Rreci**

No.	Lot
1	048 - Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku Idriz Rreci

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **11,111.11 €**;
[Njëmbëdhjetë mijë njëqind njëmbëdhjetë euro në njëmbëdhjetë cent].

Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: Plani dinamik i kontratës: 21 ditë pune brenda 1 muaji.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cëkin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Valmir Loshi B.I., Rr.20 Qeshori, -, ISTOG, Kosovë


E-mail: loshi-design@hotmail.com ; Numri fiskal: 811226564

Personi kontaktues: Valmir Loshi Telefoni: 044/208-136

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	19.11.2025
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	VALMIR LOSHI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	19/11/2025
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 643-25-8426-5-2-1/C578

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve; në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Neni 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikën, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuëse të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për t'i lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e dësja gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisionëve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktivitetëve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30**Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuara vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**Neni 31 . Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34

Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe /ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35

Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrëgjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrëgjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimi të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimi të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 643-25-8426-5-2-1/C578

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, në kohëzgjatje prej 2 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>Sipas legjislacionit në fuqi</i>; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>Sipas legjislacionit në fuqi</i>; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>Sipas legjislacionit në fuqi</i>; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>Sipas legjislacionit në fuqi</i>; (ii) të personave të tjerë: <i>Sipas legjislacionit në fuqi</i>;
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Punimet fillojnë me datën e urdhëresës së Letres për fillimin e punimeve në formë elektronike, me e-mail zyrtar apo në formë fizike nga Menaxheri i Kontratës, i emëruar me vendim të ZKA-se; Data e fillimit do të jetë sipas Planit të Menaxhimit të Kontrates, pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>Mbrenda 1 muaji, kur Projekt Menaxheri kërkon të realizoj kontratën afati për fillim apo përfundim është 21 ditë pune!</i>

		<i>-Pranimin i punëve , bëhet nga komisioni në përbërje të plotë prej tre (3) apo (5) anëtarësh të emëruar me vendim të caktuar , me Ligjin - Rregulloret në fuqi.</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët që nuk janë realizuar konform planit dinamik, dhe të vërtetuara me regjistrin e punëve në vend punishte janë 0.05% për ditë. -Shuma totale e të metave të likuiduara nuk mund të tejkalojë 10% të shumës së përcaktuar në kontratë; -Kontraktuesi do të konsiderohet ligjerisht përgjegjës për çdo vonesë publike në realizimin përfundimtar të punimeve; Kontraktuesi nuk duhet të bëjë asnjë vonesë në realizimin e punimeve EO, duhet të përmbahet punimeve sipas dosjes të tenderit dhe planit të Menaxhimit të Kontrates i detajuar për realizimin përfundimtar të punimeve.
Regjistri i punës	20.1	<i>[Specifikoni nëse një regjister i punës nuk është nevojitet].</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Kontrates/projektit nga AK-Skenderaj, rezervon të drejtën ligjore që në çdo kohë të bëjë verifikimin e cilësisë së materialit/punëve në vend punishte drejtpërdrejtë. Menaxheri i Kontrates/ Projektit, gjatë pranimi të përkohshëm nëse konstatojnë se ka defekte do të lajmërohet menjëherë Kontraktuesin, që të bëjë korrigjimin e defekteve të tilla, deri të pranimi i përgjithshëm – pranim dorëzimit i objektit. Kontraktuesi përmirësimin dhe riparimin e defekteve e bënë në kuadër të shpenzimeve të tij.
		70.5 Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA). Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në bashkëpunim me Njësinë e Kërkesës do t'i propozojë ZKA-së një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës nëse aplikohet, të cilët do të kenë përgjegjësi si në paragrafet 70.23-25. ZKA me vendim do ta emërojë Menaxherin e Kontratës dhe mbikqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.
		70.11 Plan i për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas nënshkrimit të kontratës. Palët e kontratës, përkatësisht Menaxheri i Kontratës nga ana e AK dhe Menaxheri i Kontratës nga ana RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar 146 e OE duhet të pajtohen për afatet dhe obligimet e përcaktuara në planin për menaxhimin e kontratës në pajtim me kushtet e kontratës, dokumentohet me nënshkrimin e palëve, si dhe aprovimin e palëve në platformën e e-prokurimit.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas planit dinamik, pas nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjësia Defektet	mbi 34.5	Periodha garantuese e defekteve do të jetë 24 muaj. Kontraktuesi është i obliguar që sipas kërkeses së Autoritetit Kontraktues, të bëjnë permisimin – intervenimin për gjatë kohës së periudhës së garantimit. Operatori Ekonomik, Kontraktuesi i Punimeve duhet ta dorëzojë sigurimin e ekzekutimit në vlerë 10% të kontratës së përgjithshme, ku ky garancion do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontratës, në kohëzgjatje prej 24 muajve, pas pranimit dorëzimit përfundimtar të punëve. Ky garancion i ekzekutimit duhet të jetë nga një Kompani Sigurimesh të licensuar në Republikën e Kosovës. Sigurimi i ekzekutimit për garantimin e punëve – objektit të përfunduar duhet të sillet në Autoritetin Kontraktues me pagesën e fundit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve në mes të dy palëve</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet tek [Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti Ekonomik].</i> <i>ose</i> <i>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</i>

PARAMASA DHE PARALLOGARIA**PROJEKTI: NDERTIMI I ZONES REKREATIVE NE PARKUN "IDRIZ RRECI" KINO NE NATYRE****LOKACIONI: SKENDERAJ****INVESTITORI: KOMUNA E SKENDERAJIT****VËREJTJE:**

Materialet e propozuara në paramasë janë pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv por çdoher të aprovuara nga Organi Mbikqyres respektivisht drejtoria përkatëse. NE TE GJITHA POZICIONET PËRFSHIHET FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI, TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI, VENDOSJA E SKELERISË SË NEVOJSHME DERI NË PËRFUNDIM TË POZICIONËVE NË LARTËSI. RREZIKSHMËRINA E PUNËTORËVE NË LARTËSI ËSHTË OBLIGIM I KOMPANISË PUNËKRYESE.

		NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1	Përshkrimi i punëve				
1.1	Germimi i dheut të kategorise III dhe IV dhe vendosja per ne pjesen pas tribunave	m3	9.30	5.00 €	46.50 €
1.2	Furnizimi dhe vendosja e dheut për pjesen nën tribuna	m3	30.00	10.00 €	300.00 €
1.2	Nivlizmi dhe ngjeshja e nenbazës	m2	18.60	3.00 €	55.80 €
1.3	Furnizimi dhe vendosja e zhavorit 0-63mm me trashesi t=40cm me nivelizim dhe ngjeshje	m3	7.44	15.00 €	111.60 €
1.4	Furnizimi dhe vendosja e zhavorit 0-31.5mm me trashesi t=10cm me nivelizim dhe ngjeshje	m3	6.34	15.00 €	95.10 €
1.5	Furnizimi dhe punimi i gjithë struktures me blloka argjilore gjysemgiter me trashesi t=12 cm me te gjitha elementet percjellese si laq per muratim si dhe te planifikohet hapje para dhe prapa objektit ne vendet e plaifikuara. Ne pozicion perfshihet edhe lysterja e brendshme e objektit me te gjitha fazat dhe elementet deri ne finale fasade 1mm. Ne pozicion perfshihet cdo elemente perberes i pozicionet deri ne dorezim final.	m2	43.00	25.00 €	1,075.00 €
1.6	Furnizimi dhe vendosja e betonit te armuar per bazen dhe shtyllat ne 4 qoshe te objektit me marke C-25/30 ku perfshihet kallupimi dhe armatura	m3	8.44	100.00 €	844.00 €
1.7	Furnizimi dhe vendosja e betonit te armuar ne tribuna te objektit te markes C-25/30 ku perfshihet edhe kallupimi dhe armatura	m3	37.00	100.00 €	3,700.00 €
1.8	Furnizimi dhe mveshja me pllake guri me trashesi 5 cm ne pjesen e perparme si dekorim si dhe atike	m2	20.28	30.00 €	608.34 €
	Furnizimi dhe montimi i Sandwich panelit per kulm me aksesar percjelles ku trashesia e panelit duhet te jete t=50mm. Materiali ne pjesen e jashtme duhet te jete llamarine e valezuar me trashesi t=0.5mm dhe ne pjesen e brendshme duhet te jete llamarine me trashesi t=0.5mm me mbushje poliuretan. Gjerisa e paneleve duhet te jete 100cm dhe koeficientet termike, mbrotja e zerit dhe pesha duhet te jete sipas normave EN. Ne kete pozicion perfshihen te gjitha elemetet tjera percjellese si bulona dhe goma speciale qe nuk korodohen, llamarina ne lugje dhe ne kulmore dhe pjesa te tjera te imta deri ne finalizim te tersishem te pozicionit. Ne pozicion perfshihen edhe vendosja e trajeve nga druri 12x12cm ne distance 80cm njeri nga tjeteri si dhe vendosja e listelave dhe kontrollistelave si dhe cdo element tjeter deri ne finalizim total te pozicionit.	m2	13.92	20.00 €	278.40 €
2					

2.1	Furnizimi dhe vendosja e TV's me kapacitet: * Përmasat: 98" (inch) * Rezolucioni: 4K Ultra HD (3840 x 2160) * Tv për ambiente të jashtme HDR, HDR10+, HLG * Netflix, YouTube, Amazon Prime, AppleTV+ * AI PQ Processor 3.0 (Quad-core) * 3 x HDMI 2.1, USB, Optical * Wi-Fi * Zëri: 30W, Dolby Audio	* 4K copë	1.00	999.30 €	999.30 €
2.2	Mbajtës lëvizës për TV * Këndi vertikal: +3 - 15° * Këndi horizontal: +/- 90° * Peshë maksimale: 70 kg * Vesa: 100x100 200x200-400x400 mm Apo mbajtës tjetër opsional vetëm të ketë aftësi mbajtëse të TV's	copë	1.00	100.00 €	100.00 €
3	Sistem zërimi (soundbar) * Fuqia: 400W * Numri kanaleve: 5.1ch * Bluetooth v5.0 * 1 x HDMI, 1 x USB x Optical I konjektueshem me TV	copë	1.00	500.00 €	500.00 €
3.1	Mvesheja e verandës me profile druri 8x2.5 cm, rezistent ndaj ndikimeve atmosferike si dhe vendosja e tyre në ulse të tribunave sipas projektit	m'	101.00	10.00 €	1,010.00 €
3.2	Porosia dhe montimi i kuadrit të kyqjes shpërndaress (KKSH) epunuar nga llamarinë dy herë e dekomprimuar, RAL 7032, me dimensione 1200x262x900 mm (GJxTxl), me shkallë të izolimit IP 65 përmba, si dhe betonimi i bazamentit të KKSH. Tri siguresa të tipit NVO 50/63A Një shkarkues të mbitemsonit B+C Siguresat gjysmëautomatike 16A, të klases C. Prodhues Gewiss, Legrande apo i ngjashëm Fid 40/0.03A nga prodhuesit LEGRAND, TICINO dhe GEWIS Furnizimi dhe montimi i releut fotovoltaiq për komandimin e ndriqimit të rugeve Si dhe cdo Material tjetër lidhës	copë	1.00	400.00 €	400.00 €
3.3	Hapja e kanaleve për shtrirjen e kabllave me thellesi 80cm. Kabllot mbrohen në përputhshmeri me normat teknikat (shtrirja e reres se imet për mbrojtje, mbulimi i kabllave me mbrojtës GAL, si dhe vendosja e shirititit sinjalizues) Kabell PP-Y3x2.5mm2 Kabell PP00-A 4x16mm2 Gyp i brinjëzuar me litar tërheqës PE-F170mm	m'	25.00	20.00 €	500.00 €
3.4	Furnizimi dhe vendosja e prizave dhe vendeve për kyqje të TV's dhe gjithë sistemit në energji elektrike në 2 prize 6 kokshe në lartësi 1m mbi bazë.	copë	2.00	10.00 €	20.00 €
3.5	Furnizimi dhe vendosja e një dërrë metalike me dim 210x90 cm me ngjyrë antracid duke përdorur paraprakisht ngjyrë mbrojtëse ndaj korrozionit, në pjesën anësore e objektit e paisur me 3 dryna bllokues të dërrës për mbrojtje nga dëmtimi i objektit apo vjedhjes së elementeve në të.	copë	1.00	200.00 €	200.00 €
3.6	Furnizimi dhe vendosja e një dërrë metalike rreshqitëse me dim. 268x 140 cm me ngjyrë antracid duke përdorur paraprakisht ngjyrë mbrojtëse ndaj korrozionit, për mbrojtjen e TV-s në pjesën ballore e objektit e paisur me 3 dryna bllokues të dërrës për mbrojtje nga dëmtimi i objektit apo vjedhjes së elementeve në të.	copë	1.00	267.07 €	267.07 €
Totali:				11,111.11 €	



ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

SPECIFIKIMET TEKNIKE – KINO NË NATYRË

Pozicioni 1.1 – Gërmimi i dheut të kategorisë III dhe IV dhe vendosja pas tribunave

- **Përshkrimi i punës:** Të kryhet gërmimi i dheut të kategorisë III–IV sipas kushteve të terrenit. Materiali i gërmuar vendoset në pjesën pas tribunave.
 - **Materiali:** Dheu ekzistues i kategorisë III–IV.
 - **Metoda e punës:** Përdorim i ekskavatorëve dhe transport me kamionë; shtrirja dhe nivelimi sipas projektit.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Të arrihen thellësitë dhe sheshrimi i kërkuar; sipërfaqja të jetë e pastër nga mbetje organike.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.2 – Furnizimi dhe vendosja e dheut për pjesën nën tribuna

- **Përshkrimi i punës:** Puna përfshin transportin dhe vendosjen e dheut të përshtatshëm për mbushje nën tribunat.
 - **Materiali:** Dheu i seleksionuar, pa gurë të mëdhenj dhe mbetje organike.
 - **Metoda e punës:** Shtrimi në shtresa ≤ 25 cm me kompaktim të çdo shtrese.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Kompaktësia min.90% Proctor Standard.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.2 – Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës

- **Përshkrimi i punës:** Shtrimi, nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës përpara shtrimit të shtresave të tjera.
 - **Materiali:** Nën baza e mbushur me dhe apo zhavorr.
 - **Metoda e punës:** Përdorim i buldozerit dhe kompaktorëve vibrues.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Trashësia dhe rrafshësia sipas projektit.
 - **Njësia e matjes:** m²
-

Pozicioni 1.3 – Furnizimi dhe vendosja e zhavorrit 0–63 mm, t=40 cm

- **Përshkrimi i punës:** Shtrimi i shtresës së zhavorrit 0–63 mm me trashësi 40 cm, me nivelizim dhe ngjeshje.
 - **Materiali:** Zhavorr granulometrik 0–63 mm, i pastër.
 - **Metoda e punës:** Shtrimi në shtresa 20 cm me kompaktim mekanik.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Kompaktësia $\geq 95\%$ Proctor Standard.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.4 – Furnizimi dhe vendosja e zhavorrit 0–31.5 mm, t=10 cm

- **Përshkrimi i punës:** Shtrimi i shtresës së zhavorrit 0–31.5 mm me trashësi 10 cm, me nivelizim dhe ngjeshje.
 - **Materiali:** Zhavorr granulometrik 0–31.5 mm.
 - **Metoda e punës:** Shtrimi në një shtresë të vetme, ngjeshje me kompaktor vibruese.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Trashësia, rrafshësia dhe dendësia të jenë sipas projektit.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.5 – Struktura me blloka argjilore, muratim dhe lyerje finale

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe punimi i muraturës me blloka argjilore t=12 cm për gjithë strukturën, me llaq për muratim, hapje të parapara, si dhe lyerje të brendshme dhe fasadë finale 1 deri 1.5 mm. Përfshihen të gjitha elementet deri në dorëzim final.
 - **Materiali:** Blloqe argjilore t=12 cm, llaq për muraturë, material për lyerje dhe fasadim.
 - **Metoda e punës:** Muraturë sipas projektit, aplikim i lyerjeve në disa shtresa deri në finalizim.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Vendosja dhe lidhja e muraturës, rrafshësia, cilësia e lyerjes dhe fasadës finale.
 - **Njësia e matjes:** m² / komplet
-

Pozicioni 1.6 – Betoni i armuar për bazë dhe shtylla qoshe (C-25/30)

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe vendosja e betonit C-25/30 për bazën dhe 4 shtylla qoshe, duke përfshirë kallëpimin dhe armaturën.
 - **Materiali:** Beton C-25/30, hekur për armaturë B500.
 - **Metoda e punës:** Përzierje, vendosje në kallëpe dhe vibrim me vibrator.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Certifikatë betoni, përputhje me projektin, dendësi dhe pozicion i armaturës.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.7 – Betoni i armuar në tribuna (C-25/30)

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe vendosja e betonit C-25/30 për tribunat, me kallëpim dhe armaturë.
 - **Materiali:** Beton C-25/30, hekur për armaturë B500.
 - **Metoda e punës:** Kallëpim, montim armature, vendosje betoni me vibrim.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Cilësia e betonit dhe përputhshmëria me dimensionet e projektit.
 - **Njësia e matjes:** m³
-

Pozicioni 1.8 – Veshja me pllakë guri t=5 cm në pjesën e përparme dhe atike

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe veshja dekorative me pllaka guri natyror 5 cm në fasadën e përparme dhe atike.
 - **Materiali:** Gurë natyral të përpunuar t=5 cm.
 - **Metoda e punës:** Vendosje me ngjitës special ose llaç, sipas projektit.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Cilësia e sipërfaqes, trashësia uniforme, rreshtimi i gurëve.
 - **Njësia e matjes:** m²
-

Pozicioni 2 – Sandwich panel për kulm (t=50 mm)

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe montimi i paneleve “sandwich” për kulm me trashësi 50 mm, llamarinë e valëzuar 0.5 mm jashtë dhe brenda, me mbushje poliuretani. Përfshihet edhe montimi i traëve prej druri 12x12 cm, listelave, kundërlistelave, bulonave, gomave speciale dhe llamarinave të kulmit deri në përfundim total.
 - **Materiali:** Panelet sandwich, tra druri 12x12 cm, aksesore metalikë.
 - **Metoda e punës:** Montim sipas normave EN, me izolim termik.
 - **Kontrolli i cilësisë:** Përputhshmëri me projektin dhe normat EN.
 - **Njësia e matjes:** m²
-

Pozicioni 2.1 – Televizor 98” për ambiente të jashtme

- **Specifikime:**
 - Përmasat: 98” (inch)
 - Rezolucioni: 4K Ultra HD (3840x2160)
 - HDR: HDR10+, HLG
 - Sistemi smart: Netflix, YouTube, Amazon Prime
 - Procesor: AiPQ 3.0 (Quad-core)
 - Lidhjet: 3x HDMI 2.1, USB, Optical, Wi-Fi
 - Audio: 30W Dolby Audio
 - **Metoda e punës:** Montim dhe testim funksional.
 - **Njësia e matjes:** copë
-

Pozicioni 2.2 – Mbajtës lëvizës për TV

- **Specifikime:**
 - Këndi vertikal: $+3^{\circ} - 15^{\circ}$
 - Këndi horizontal: $\pm 90^{\circ}$
 - Pesha maksimale: 70 kg
 - VESA: 100x100 – 400x400 mm
 - **Metoda e punës:** Montim në mur/pllafon - konstrukcion me bulona të përshtatshme.
 - **Njësia e matjes:** copë
-

Pozicioni 3 – Sistem zëri (Soundbar 5.1ch)

- **Specifikime:**
 - Fuqia: 400W
 - Kanale: 5.1
 - Lidhje: Bluetooth 5.0, HDMI, USB, Optical
 - I konektueshëm me TV
 - **Metoda e punës:** Montim, konfigurim dhe testim audio.
 - **Njësia e matjes:** komplet
-

Pozicioni 3.1 – Mbështjellja e verandës me profile druri 8x2.5 cm

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe montimi i profileve druri 8x2.5 cm për verandën dhe ulëset e tribunave.
 - **Materiali:** Dru i trajtuar kundër lagështisë dhe dëmtimit atmosferik.
 - **Metoda e punës:** Montim sipas projektit.
 - **Njësia e matjes:** m² / komplet
-

Pozicioni 3.2 – Kuadri i kyçjes shpërndarës (KKSH)

- **Specifikime:**
 - Material: Ilamarinë e dekompresuar, RAL 7032
 - Dimensione: 1200x262x900 mm
 - Izolim: IP 65
 - Përfshin: siguresa thik tip NVO 50/63A, shkarkues mbitemension B+C, siguresa 16A C, FID 40/0.03A, rele fotovoltai
 - **Metoda e punës:** Montim elektrik sipas standardeve.
 - **Njësia e matjes:** komplet
-

Pozicioni 3.3 – Hapja e kanaleve për kablo

- **Përshkrimi i punës:** Hapja e kanaleve 80 cm për shtrirjen e kabllave, mbrojtja me rërë të imët, mbrojtës GAL dhe shirit sinjalizues.
 - **Materiali:** Kabllo PP-Y 3x2.5 mm², kabllo PP00-A 4x16 mm², gyp PE fi 70 mm me litar tërheqës.
 - **Metoda e punës:** Hapje kanalesh, vendosje kabllosh sipas normave teknike.
-

Pozicioni 3.4 – Priza dhe vende kyçjeje

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe vendosja e 2 prizave 6-kokëshe për TV dhe sistemin elektrik, në lartësi 1 m mbi bazë.
 - **Materiali:** Priza cilësore IP 44/55.
 - **Metoda e punës:** Montim dhe lidhje në rrjetin elektrik.
 - **Njësia e matjes:** copë
-

Pozicioni 3.5 – Derë metalike 210x90 cm

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe vendosja e derës metalike 210x90 cm, ngjyrë antracit, me trajtim kundër korrozionit dhe 3 dryna bllokues.
 - **Materiali:** Profil metalik, llamarinë e lyer me bojë mbrojtëse.
 - **Metoda e punës:** Montim mekanik sipas projektit.
 - **Njësia e matjes:** copë
-

Pozicioni 3.6 – Derë metalike rrëshqitëse apo me hapje horizontale 268x140 cm

- **Përshkrimi i punës:** Furnizimi dhe vendosja e derës rrëshqitëse apo me hapje horizontale prej metali me dim. 268x140 cm për mbrojtjen e TV-së, ngjyrë antracit, me trajtim kundër korrozionit dhe 3 dryna bllokues.
- **Materiali:** Profil metalik, llamarinë e mbrojtur.
- **Metoda e punës:** Montim mekanik me sistem rrëshqitës.
- **Njësia e matjes:** copë



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **K.K. SKENDERAJ**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **N.N.T. Loshi-Design , Gurrakoc,Istog Istog**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: 048 - Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku Idriz Rreci

643-25-8426-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Nje mije e Nje qinde e Njembdhjet e Njembdhjet 1,111.11 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,111.11 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **60 ditë prej 17.11.2025 deri më 16.01.2026**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar


K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistrallja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



Në mbështetje të Nenit 87.2.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 (këtu e tutje LPP), Bordi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, miraton:

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

(Versioni i Konsoliduar)

Ky version i Konsoliduar i RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nuk është zyrtar dhe është përgatitur për nevojat e brendshme të KRPP-së, AQP-së, OSHP-së, Autoritetet Kontraktuese, Operatorët ekonomik dhe personat tjerë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit.

Teksti me ngjyrë të gjelbërt është Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.001/20022 për prokurimin publik që hynë në fuqi nga 11.11.2024

Prishtinë, 01 Nëntor 2022

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – **Versioni i konsoliduar**

Neni 53

Kontratat e Pronës së Paluajtshme

53.1 Sipas nenit 3.9 të Ligjit të Prokurimit Publik, pasuria e paluajtshme është e përjashtuar. Kjo do të thotë që autoritetet kontraktuese nuk do të zbatojnë këtë ligj për kontratat në lidhje me dhënie, blerjen, ose marrjen me qira të tokës, ndërtesave ose pronave tjera të paluajtshme ose të drejtat në lidhje me të tilla, përveç kur parashikohet në ligje të veqanta në fuqi.

Neni 54

Kontratat Kornizë

54.1 “Kontratë publike kornizë” nënkupton një marrëveshje për një periudhë të caktuar në mes të një apo me shume autoriteteve kontraktuese si dhe një apo më shumë Operatorëve ekonomik, qëllimi i të cilës është vendosja e termave që udhëheqin kontratat që duhen dhënë gjatë një periudhë të caktuar, posaçërisht në lidhje me çmimin si dhe, kurdo që është e përshtatshme edhe sasinë e theksuar.

54.2 Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/mirëmbajtje), e cila i vendosë termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes.

- 54.3 Kontratat publike kornizë i përcaktojnë termat dhe kushtet sipas të cilave bëhen kontratat ndihmëse ose porositë. Me këtë qasje kontratat do të lidhen vetëm kur mallrat dhe shërbimet janë urdhëruar ose “kërkuar” sipas kontratës publike kornizë.
- 54.4 Mjetet për dhënien e kontratës sipas marrëveshjeve për kontrata publike kornizë sigurohen pa pasur nevojë që të *ri-shpallet* dhe *ri-aplikohen kriteret e përzgjedhjes* dhe kriteret e shpërblimit prej fillimit. Me tutje është e mundshme që autoriteti kontraktues të lidh kontratë në emër të një numri të autoriteteve tjera kontraktuese e të cilat më pastaj mund ta përdorin këtë kontratë pa pas nevojë që të tenderohen sipas LPP-së. Në këtë mënyrë kursehen shumë burime.
- 54.5 Kontratat publike kornizë mund të përdoren vetëm nga palët të cilat kanë qene pjese e atij aktiviteti.
- 54.6 Një numër i autoriteteve kontraktuese mund të bëjnë marrëveshje për të përdorur kontratat kornizë të përbashkëta. Kurdo që kontrata publike kornizë do të përdoret nga disa Autoritete Kontraktuese ato duhet të identifikohen shprehimisht në Njoftimin mbi Kontratë, qoftë duke i emëruar ata drejtpërdrejt në njoftimin mbi kontratë ose përmes referencës tek dokumentet tjera.
- 54.7 **Autoriteti** Kontraktues para inicimit të aktivitetit të prokurimit duhet të siguroj nëse kontrata **publike** kornizë është qasja më e mirë për prokurimin përkatës. Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet nëse përdorimi i kontratës publike kornizë synon nxjerrjen e vlerës së parasë së dhënë duke marr parasysh natyrën e prokurimit si dhe aftësinë që të specifikoj prokurimin me përpikëri të mjaftueshme qysh në fillim.
- 54.8 Qeveria mund të vendos që të gjithë autoritetet kontraktuese të përkufizuara në Nenin 4 të LPP-së, duhet që ti nënshtrohen kontratave kornizë dhe kështu nuk lejohen të bëjnë prokurimin e mallrave, shërbimeve ose punëve nga operatorë të tjerë ekonomik dhe me kushte të tjera nga ato të dakorduara në kontratën kornizë. AQP, në pajtim me Nenin 95 të LPP-se, do të kryej dhe do të jetë përgjegjës për prokurimet sipas kontratës së tillë kornizë. Në rast të aktiviteteve qendrore të prokurimit, si kontrata publike kornizë e zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit në emër të Autoriteteve kontraktuese të tjera, përdorimi i këtyre kontratave qendrore janë obligative për Autoritetet Kontraktuese.
- 54.9 Autoriteti kontraktues nuk mund të përdor kontratat publike kornizë në mënyrë të tillë që të parandaloj dhe kufizoj konkurrencën.
- 54.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është *vetëm sasi indikative*. Kurdo që Autoriteti Kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti Kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit *vlerën ose sasinë e kontratës* si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk

mund të jetë më e lartë se *plus/minus tridhjetë përqind (30%)*. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëhere kontrata përfundon me *vlerën ose sasinë e kontratës* si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse Autoriteti Kontraktues deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë *sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative* të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar *plus/minus tridhjetë përqind (30%)* vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

54.11 Mospërputhja e lejuar konsiston në *plus/minus tridhjetë përqind (30%)* të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës, mirëpo, *kjo nuk do të thotë që Operatori Ekonomik duhet të paguhet për punët (riparim, mirëmbajtje), shërbimet apo furnizimet e pa porositura nga Autoriteti Kontraktues*. Sipas këtij kufizimi (+/-30%), Autoriteti Kontraktues merr përsipër që të porositë, pranoj dhe paguaj sasinë totale prej së paku shtatëdhjetë përqind (70%) nga sasia indikative e vendosur në dosjen e tenderit përkatësisht në kontrate, prandaj autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh këtë fakt sidomos në fazën e përgatitjes së sasive indikative në dosje të tenderit e cila në secilin rast nuk guxon të ndryshojë në plus/minus 30 % e vlerës indikative.

54.12 Në çdo rast kur për çfarëdo arsye objektive një gjë e tillë do të ketë ndodhur (ka pushuar nevoja për furnizimet e tilla), Autoriteti Kontraktues duhet të:

- Bëjë përpjekje që përmes dispozitave nga kontrata për zgjidhje miqësore të kontesteve kontraktuale me kontraktorin kontesti në fjalë të zgjidhet me marrëveshje mirëkuptimi dhe mirëbesimi me Operatorin Ekonomik;
- Në rast se palët nuk arrijnë të zgjedhin kontestin me marrëveshje, pala e pa kënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente.

54.13 Ndërsa Autoritetet Kontraktuese duhet që:

- Gjatë përzgjedhjes së procedurave të prokurimit, inicimit dhe zhvillimit të tyre gjithmonë të kenë parasysh plotësimin e nevojave të domosdoshme dhe që kjo të realizohet sipas qëllimit të Ligjit të Prokurimit Publik të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 1 të LPP.
- Të merren masat e nevojshme që planifikimet e aktiviteteve të prokurimit të kryhen në mënyrë efikase dhe të drejtë, sidomos në përcaktimin e qartë të nevojave dhe gjithmonë duke i respektuar dispozitat ligjore të prokurimit.
- Të kenë kujdes të veçantë që gjatë administrimit të procedurave, të luajnë rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë të **çmimet**, dhe **sasitë** dhe sidomos

përcaktimit të drejtë të nevojave në mënyrë që sasia indikative në asnjërin rast të mos pësojë ndryshime +/-30% nga sasia e përcaktuar si indikative.

54.14 Duhet të merren masat e nevojshme që Autoriteti Kontraktues që si pasojë e veprimit apo mos veprimit të tyre, neglizhencës apo mungesës së vullnetit, të mos bien ndesh me dispozitat e Ligjit dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik dhe/ose legjislacionit tjetër në fuqi si rezultat i parashikimit jo të saktë të sasive indikative, apo për arsye tjera shkaqet e të cilave është dashur të parashikohen me kohë gjatë parashikimit të sasive, autoriteti kontraktues duhet të ndërmarrë masa ligjore ndaj zyrtarit/ve përkatës të cilët kanë përgatitur kërkesat e tilla.

54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, *kontratat me çmime për njësi*, Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve/**artikujve**” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani *plus/minus tridhjetë përqind (30%)*, si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve, **pajisjeve të ndryshme** etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për **llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime**. Kërkesat nga ky paragraf duhet të vendosen në Dosjen e Tenderit dhe në **Njoftimin për Kontratë**. Për qëllime raportimi dhe statistikore në rast të aplikimit të kontratës kornizë kur sasi të indikative nuk dihen dhe kontrata është me çmime për njësi, Autoriteti Kontraktues në përgatitjen dhe publikimin e “*Njoftimit mbi vendimin e AK*” duhet të vendosë çmimet totale të tenderuesve, ndërsa gjatë përgatitjes dhe publikimit të “*Njoftimit për dhënie të kontratës (B08)*”, për kontratën kornizë të nënshkruar dhe “*Njoftimit për nënshkrimin e kontratës*” duhet të vendosë vlerën e parashikuar të kontratës kornizë, duke specifikuar qartë me një paragraf (në B08, B52 – në pjesën V: informacionet shtesë dhe në kontratën e nënshkruar) qëllimin e vendosjes së vlerës së parashikuar.

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë

54.16 Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë nuk mund të jetë më e gjatë se **36 muaj**.

54.17 Sidoqoftë kontratat që dalin prej kontratës publike kornizë mund të vazhdohen përtej afatit të skadimit të kontratës publike kornizë që nënkupton se nëse kontrata ndihmëse ose bërja e urdhrat është dhënë pak kohë para së kontrata publike kornizë të skadojë, dërgesa mund të bëhet pas datës së skadimit. Keqpërdorimi i kontratës publike kornizë nuk lejohet prandaj duhet t'i kushtohet kujdes që të mos shmangen rregullat duke kërkuar dërgesën kohë të gjatë pas mbylljes së kontratës publike kornizë.

KAPITULLI V - Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i përformancës së kontraktuesve

Neni 70

Dispozitat e përgjithshme

- 70.1 Menaxhimi i Kontratës – i referohet administrimit të implementimit të kontratave nga ana e autoritetit kontraktues nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistemit të prokurimit elektronik. Të gjithë zyrtarët/ personat e caktuar/emëruar si menaxherë të kontratës si nga ana e AK dhe OE duhet të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
- 70.2 Vlerësimi i përformancës së kontraktuesve – i referohet vlerësimit të përformancës së kontraktuesve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë. Vlerësimi i përformancës së kontraktuesve do të behet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të përformancës së kontraktueve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësim të përformancës së kontraktueve.
- 70.3 Termi “kontratë” i referohet, Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), Kushteve të Veçanta të Kontratës(KVK), dhe Listës së Çmimeve.
- 70.4 KPK mbulojnë të gjitha aspektet e mundshme lidhur me obligimet e Operatorit Ekonomik në lidhje me kontratën dhe përkufizojnë shkeljen, shkeljen themelore të termave dhe mjetet juridike që vlejnë për secilën palë. KPK mbeten të pandryshuara në formatin e paraqitur në dosjen e tenderit. KVK plotësojnë, shtojnë, apo ndryshojnë dispozitat e KPK-së. Kurdo që ka konflikt, do të mbizotërojnë Kushtet e Veçanta. Lista e çmimeve duhet të përmbajë listën e plotë të çmimeve të OE të cilit i është dhënë kontrata.

Bartja e përgjegjësisë të Menaxheri i Projektit/Kontratës

- 70.5 Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA). Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në bashkëpunim me Njësinë e Kërkesës do t'i propozojë ZKA-së një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikqyres të drejtpërdrejte të menaxherit të kontratës nëse aplikohet, të cilët do të kenë përgjegjësitë si në paragrafet 70.23-25. ZKA me vendim do ta emërojë Menaxherin e Kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.
- 70.6 Zyrtari i prokurimit, menaxherin e kontratës (për vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe) dhe mbikqyrësin e drejtpërdrejte (vlerë të mesme dhe vlerë të madhe) të emëruar nga ZKA do t'i vendosë në hapat përkates gjatë përgatitjes së njoftimit për nënshkrim të kontratës sipas nenit 21.8 të kësaj rregullore.
- 70.7 Menaxhimi i kontratës bëhet për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe, ndërsa vlerësimi i performancës së kontraktuesve bëhet vetëm për kontratat me vlerë të mesme dhe vlerë të madhe.
- 70.8 Me publikimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës, menaxheri i kontratës dhe mbikqyresi i drejt përdrejtë i menaxherit të kontratës do të njoftohen automatikisht nga sistemi i prokurimit elektronik për emërimet përkatëse dhe për kontratën e nënshkruar. Me publikimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës, kontrata e nënshkruar do të jetë në dispozicion për shkarkim nga të gjitha palët e interesuara.
- 70.9 Pasi të jetë publikuar kontrata dhe emëruar menaxheri i kontratës, menaxhimi i kontratës, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë, do të kalojë nga Departamenti i Prokurimit të Menaxheri i Kontratës. Në rast të ndryshimit ose ndërprerjes së kontratës, procesi i ngarkimit të dokumenteve mbi vendimin e plotëfuqishëm për ndryshim ose ndërprerje (me të cilat njoftohet kontraktuesi) në sistem të prokurimit elektronik do të bëhet nga menaxheri i kontratës.
- 70.10 Pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet do të përgatis dhe krijoj një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur funksionin “ Fillimi/mobilizimi i kontratës”. Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël.
- 70.11 Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas nënshkrimit të kontratës. Palët e kontratës, përkatësisht Menaxheri i Kontratës nga ana e AK dhe Menaxheri i Kontratës nga ana

e OE duhet të pajtohen për afatet dhe obligimet e përcaktuara në planin për menaxhimin e kontratës në pajtim me kushtet e kontratës, dokumentohet me nënshkrimin e palëve, si dhe aprovimin e palëve në platformën e e-prokurimit.

70.12 Pas aprovimit dhe nënshkrimit të Planit për menaxhim të kontratës, i njëjti plan do të jetë në dispozicion për shkarkim nga ana departamentit të prokurimit.

70.13 Menaxheri i Kontratës do t'i lëshojë Operatorit Ekonomik:

- a. Letrën e fillimit të punëve, në rastin e kontratës për pune;
- b. Letrën e njoftimit, në rast të kontratës për shërbime; dhe
- c. Flete porosinë, në rast të kontratës për furnizime.

70.14 Menaxheri i kontratës do ta pajis Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit me një kopje të dokumentit të përmendur nën 70.10 që do të bëhet pjesë përbërëse e kontratës.

70.15 Në rast të kontratës publike kornizë apo marrëveshjeve me afat të gjatë, atëherë kur është e mundur, Menaxheri i Kontratës do të lëshojë Fletë porosi çdo herë kur shfaqet nevoja.

70.16 Kurdo që Menaxheri i Kontratës ka rezerva ose vështirësi me termat dhe kushtet e kontratës, ato do të diskutohen dhe zgjidhen me Departamentin e Prokurimit.

70.17 Menaxheri i Kontratës do t'i raportojë Departamentit të Prokurimit:

- (a) për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës.

Emërimi i Menaxherit të Projektit/Kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

70.18 ZKA do ta emërojë një person nga Njësia Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, si Menaxher të Kontratës dhe një person nga Njësia Kërkuese si Mbikqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.

70.19 Ku është e përshtatshme, ZKA mund të emërojë një person nga një departament tjetër si Menaxher të Kontratës. apo Mbikqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.

70.20 Për kontrata për punë dhe kontrata të projektimit emërohet Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, i cili ka përgjegjësitë e njëjta sikurse Menaxheri i Kontratës, të përcaktuara me nenin 70.23 të kësaj

rregulloreje. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës përbëhet nga profesionist sipas fushëveprimit të kontratës, ku secilit anëtar të ekipit i përcaktohet përgjegjësia për pjesë përkatëse të fushëveprimit të kontratës. Njëri nga anëtarët e ekipit emërohet si udhëheqës i ekipit dhe i njëjti poashtu do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës përmes platformës elektronike e-prokurimi.

70.21 Kontrata mund të menaxhohet nga një kontraktues i jashtëm (OE ose person jashtë Autoritetit Kontraktues). Përzgjedhja e kontraktuesit të jashtëm do të bëhet duke përdorur procedurat e përshtatshme të prokurimit për shërbime. Njëjtë si për të gjitha kontratat e nënshkruara edhe kontraktuesit jashtë AK mund të sigurohen nga ndonjë autoritet tjetër kontraktues, angazhimi i kontraktuesit të tillë do të sigurohet në bazë të një marrëveshje me shkrim me autoritetin tjetër kontraktues të cilit i përket kontraktuesi i tillë.

70.22 Menaxhimi i kontratës bëhet për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe, ndërsa vlerësimi i performancës së kontraktuesve bëhet vetëm për kontratat me vlerë të mesme dhe vlerë të madhe, prandaj gjatë përgatitjes dhe publikimit të njoftimit për nënshkrim të kontratës (B52) Menaxheri i Kontratës emërohet për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe, ndërsa Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës emërohet vetëm për kontrata me vlerë të madhe dhe të mesme.

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

70.23 Menaxheri i kontratës do të:

- a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
- b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
- c. bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

70.24 Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

Përgjegjësitë e Mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

70.25 Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

Neni 71

Ndryshimi i kontratës

71.1 Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Menaxheri i kontratës rekomandon ndryshimin e kontratës duke përfshirë edhe arsyet për ndryshimin e kontratave ku ndryshimi i kontratës kërkon ndryshim të projektit dhe/apo specifikimeve teknike. Menaxheri i kontratës merr aprovimin paraprak të projektuesit të cilin ia bashkëngjitet rekomandimet për ndryshim.

71.2 Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës – amandamentimi i kontratës do të përgatitet nga Departamenti i Prokurimit. Amandamentimi i kontratës do të nënshkruhet nga palët që kanë nënshkruar kontratën bazë dhe do të ngarkohet në platformën elektronike.

71.3 Ndryshimi i kontratës nuk do të lëshohet Operatorit ekonomik para:

- (a) Marrjes së aprovimit nga ZKA. Aprovimi në kuptim të këtij neni nënkupton aprovim përmes komunikimit zyrtar;

(b) Zotimit të mjeteve për kontratën e ndryshuar.

71.4 Ndryshimi i kontratës për sasi të shtesë të artikujve të njëjtë do të përdorë çmimet e njëjta apo më të ulëta për njësi si në kontratën fillestare. Për pozicionet të cilat nuk ka çmime në kontratën fillestare AK duhet të zbatoj nenin 35.3 të LPP-së.

71.5 Asnjë ndryshim kontrate nuk do ta shtojë çmimin total të kontratës me më shumë se 10 % të çmimit fillestar të kontratës.

71.6 Kontratat gjatë ekzekutimit mund të ndryshohen vetëm në rastet kur ndryshimet janë jo-thelbësore.

71.7 Ndryshimet e kontratës pavarësisht nga vlera e tyre lejohen pa një procedurë të re të prokurimit kur ato fillimisht parashihen në dokumentet e tenderimit me dispozitë të veçantë të rishikimit të çmimeve, siç janë: ndryshimet në berëz, taksa, tarifa apo indekse të çmimeve dhe ky ndryshim nuk përbën kontratë të re por thjeshtë përfshinë zbatimin e kontratës ekzistuese.

71.8 Zëvendësimi i kontraktorit të cilit AK fillimisht i ka dhënë kontratën me një kontraktor të ri, përbën **një ndryshim thelbësor** të kontratës. Në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, asnjë operator ekonomik tjetër nuk lejohet të zëvendësojë ofertuesin e suksesshëm pa një procedurë të re të prokurimit, përveç në rastet kur ndryshon identiteti ligjor i kontraktorit (përballet me ndryshime strukturore siç janë ri-organizimet e brendshme të kompanisë, bashkimi me një tjetër) por në fakt mbetet kontraktori i njëjtë. Në çdo rast AK duhet të shqyrtojë nëse subjekti i ri ligjor i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të përcaktuara me nenin 65 të LPP-së.

71.8.1 Ndryshimi i kontratës për sasi të shtesë të artikujve të njëjtë do të përdorë çmimet e njëjta apo më të ulëta për njësi si në kontratën fillestare. Për pozicionet të cilat nuk ka çmime në kontratën fillestare, përkatësisht për pozicione të paparapara, Njësia e Prokurimit duhet të zbatoj nenin 35.3 të LPP-së.

71.9 Për t'u lejuar ndryshimi i kontratës, duhet të plotësohen këto kushte:

a) ndryshimi nuk është thelbësor;

b) kur ndryshimi i kontratës bëhet i nevojshëm për shkak të rrethanave të cilat AK nuk ka mund t'i parashikojë në lidhje me punën shtesë, produkte ose shërbime të nevojshme, por që, për arsye teknike, mund të ofrohen vetëm nga kompania palë e kontratës aktuale.

c) Ndryshimet e kontratës publike bëhen në dy raste:

i) Në rastin kur ndryshimi i kontratës ka kosto financiare shtesë duke mos tejkaluar 10% e vlerës së kontraktuar. Njësia e Prokurimit duhet të zhvillojë procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 35 të LPP-së.

ii) Në rast të kontratave për punë, kur ndryshimi i kontratës nuk ka kosto financiare shtesë, duhet të iniciohet procedura për amandamentimin e kontratës. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termeve dhe kushteve fillestare, amandamentimi do të përgatitet nga Njësia e Prokurimit dhe duhet të nënshkruhet nga nënshkruesit e kontratës bazë.

- 71.10 Nën rrethana të caktuara, mund të konsiderohet si i nevojshëm një ndryshim në objektin e kontratës në mënyrë të tillë që nevojitet ofrimi i produkteve të një cilësie tjetër më të mirë ose ofrimi i shërbimeve të një lloji tjetër më të mirë në krahasim me ato të përcaktuara në kontratën origjinale pa e ndryshuar vlerën e përgjithshme të kontratës. Në këto rrethana, **ndryshimi** do të ishte i pranueshëm. Për shembull gjatë ekzekutimit të kontratës mund të ndodhë që nuk prodhohet më një produkt i caktuar, dhe në këto raste OE njofton AK, siguron dëshmi dhe propozon një produkt tjetër të një cilësie më të mirë me të njëjtin çmim.
- 71.11 Klauzola e shqyrtimit nuk mund të parashikojë **ndryshime** ose opsione që do të ndryshojnë natyrën e përgjithshme të punëve, shërbimeve ose furnizimeve që janë objekt i kontratës. Kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë e vetmja alternativë është që të ndërpritet kontrata aktuale dhe të iniciohet procedurë e re e prokurimit.
- 71.12 **Ndryshimi** duhet të konsiderohet si “thelbësor” kur plotësohen një ose më shumë nga katër kushtet, si më poshtë:
- a) Kurdo që ndryshimet në kontratë përfshijnë kushte të cilat, po të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare të prokurimit, do të kishin lejuar pranimin e ofertuesëve/kandidatëve të tjerë të ndryshëm nga ata të zgjedhur fillimisht ose pranimin e një oferte tjetër dhe jo atë të pranuar fillimisht, ose do të kishte tërhequr pjesëmarrës të tjerë në procedurën e prokurimit”, ndryshimet e tilla konsiderohen thelbësore dhe rrjedhimisht nuk lejohen. Në përputhje me këtë kusht, AK do të vlerësojë ndryshimin e propozuar me qëllim që të përcaktojë nëse do të kishte lejuar pjesëmarrje më të gjerë të OE-ve, po të ishte përfshirë si pjesë e procedurës fillestare të prokurimit.
 - b) Kurdo që propozohet ndryshimi i çmimeve të kontratës në favor të kontraktorit e që nuk ka qenë i përfshirë ky ndryshim në kontratën fillestare, do të konsiderohet ndryshim thelbësor dhe i papranueshëm.
 - c) Kurdo që ndryshimi i kontratës zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës me qëllim që të përfshihen më shumë sasi të furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë, konsiderohet ndryshim thelbësor dhe rrjedhimisht nuk lejohet.

d) Në rast se ndryshimi i propozuar i kontratës përfshin furnizimet, shërbimet apo punët të një cilësie tjetër nga ajo që ishte përcaktuar në kontratën fillestare do të konsiderohet ndryshim thelbësor, kur:

- (i) Ndryshimet në kontratë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës në rastin e kontratave publike për furnizim, shërbime dhe punë shtesë;
- (ii) Ndryshimet në kontratë tejkalojnë 30% të vlerës së kontratës apo vlerës së pozicionit në rastin e kontratave publike kornizë; dhe
- (iii) Zëvendësimi i furnizimeve, punëve apo shërbimeve të një cilësie tjetër më të dobët, qoftë edhe të një pozicioni nga ato që ishin të përshkruara në kontratën fillestare.

71.13 Barra e provës i takon Autoritetit Kontraktues që të sigurohet se ndryshimet e propozuara janë të nevojshme, nuk janë në dëm të autoritetit kontraktues si rezultat i ndryshimit sasior apo cilësor, si rezultat i keq interpretimit të specifikimeve ekzistuese ose i termeve dhe kushteve, kanë kosto-efektive, si dhe janë në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor.

71.14 Në raste kur ka ndryshime sipas një ligji, akti nënligjor apo vendimi të një organi kompetent, çmimet e kontratës duhet të rregullohen në përputhje me rrethanat.

71.15 Autoritetet Kontraktuese nuk lejohen të bëjnë ndërprerjen e kontratave në proces si dhe kontratave për punë, shërbime apo furnizimeve dhe pagesave, kur ndryshimet nuk kanë qenë të njohura, si në rastet e cekura nën paragrafin 71.14 të këtij neni.

Neni 71A

Dëmet e likuiduara (Penalltitë) gjatë zbatimit të kontratës

71A.1 Në rast të vonesave për dorëzimin e mallrave, realizimin e shërbimeve apo punëve brenda afateve kohore të specifikuara në kontratë, do të aplikohen penalltitë për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës sipas kontratës dhe datës aktuale të dorëzimit apo realizimit.

a) Nëse mosdorëzimi i mallrave apo mosrealizimi i shërbimeve nuk kufizon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve dhe shërbimeve tjera të kontraktuara, penalltitë do të llogariten barabartë me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve apo shërbimeve të pa dorëzuara/ pa realizuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë.

b) Nëse mosdorëzimi i mallrave apo mosrealizimi i shërbimeve kufizon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve dhe shërbimeve tjera të kontraktuara, penalltitë do të llogariten barabartë me 0,25% në ditë të vlerës së kontratës, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

c) Nëse mosrealizimi i punëve nuk kufizon përdorimin e zakonshëm të ndërtimit të kontraktuar, vlera e penalltive do të përcaktohet në KVK, me normë ditore për çdo ditë të vonesës së punëve të pa realizuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të punëve të parealizuara.

d) Nëse mosrealizimi i punëve kufizon përdorimin e zakonshëm të ndërtimit të kontraktuar, vlera e penalltive do të përcaktohet në KVK, me normë ditore për vlerën totale të kontratës për çdo ditë të vonesës, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

e) Në rast të vonesave në zbatimin e kontratës komizë, penalltitë do të llogariten barabartë me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, shërbimeve të pa realizuara, punëve të pa realizuara (në riparim dhe/apo mirëmbajtje), deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë.

71A.2 Aplikimi i penalltive sipas paragrafit 71A.1, bëhet si në vijim:

a) Data e fillimit të numërimit të ditëve për afatin e dorëzimit/ realizimit fillon nga data pasuese e datës së lëshimit të urdhëresave apo porosisë sipas paragrafit 70.13 të kësaj rregulloreje.

b) Nëse furnizuesi ka dështuar të realizoj kontratën/porosinë me kohë sipas afatit të dhënë në kontratë, Menaxheri i Kontratës e njofton me shkrim kontraktorin se është në vonesa dhe se ka filluar aplikimi i penalltive sipas kushteve të kontratës.

c) Menaxheri i Kontratës e përcjelle afatin kohor të aplikimit të penalltive dhe pasi të arrihet vlera maksimale e përshkruar në kontratë për penallti, duhet që të njoftoj me shkrim kontraktorin.

d) Menaxheri i Kontratës pas njoftimit me shkrim për kontraktorin duhet që të njoftoj edhe Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit (ZPP) në lidhje me vonesat dhe arritjen e vlerës maksimale të penalltive.

71A.3 Në rastet kur arrihet vlera maksimale prej 10% sipas paragrafit 71A.1 Menaxheri i Kontratës do të aplikojë penalltitë deri në max 10% sipas kushteve të kontratës, si dhe do të ndërmarrë njërin nga veprimet në vijim:

a) Do t'i rekomandojë ZPP-së dhe ZKA-së shkëputjen e kontratës dhe konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit të kontratës; ose

b) Do t'i rekomandojë ZPP-së dhe ZKA-së vazhdimin e realizimit të kontratës, në rastet kur Menaxheri i Kontratës konsideron se shkëputja e kontratës nuk është në favor të Autoritetit Kontraktues dhe se shkëputja e kontratës do të krijonte dëme më të mëdha për Autoritetin Kontraktues. Në këtë rast në komunikim me Kontraktorin duhet të vendosin afatet kohore shtesë për liferim në mënyrë që MK të jetë në gjendje të marrë masa në rast të tejkalimit të tyre. Në këtë rast, MK duhet që të njoftoj Kontraktorin për vazhdim të realizimit të kontratës dhe të paralajmëroj që nëse përsëritet prapë situata e njëjte do të merren masa për shkëputje të kontratës.

Neni 72

Ndërprerja e kontratës

- 72.1 Procesi i ndërprerjes së kontratës zhvillohet kur njëra palë e kontratës bën shkelje thelbësore të termave dhe kushteve të kontratës, ose kur si pasojë e një force madhore nuk mund të realizohet kontrata.
- 72.2 Në rast të shkeljeve nga ana e kontraktorit, Menaxheri i Kontratës evidenton shkeljet e kushteve të kontratës, vlerëson nëse duhet të ndërpritet një kontratë, dhe i dorëzon rekomandim për ndërprerje të Njesia e Prokurimit, i cili përfshinë:
- (a) emrin e kontraktorit dhe numrin e referencës të prokurimit;
 - (b) arsyet për ndërprerje;
 - (c) veprimet për shmangien e ndërprerjes;
 - (d) bazat kontraktuale për ndërprerje;
 - (e) kosto që burojnë nga ndërprerja, nëse ka ndonjë; dhe
 - (f) ndonjë informatë tjetër relevante.
- 72.3 ZPP dhe ZKA shqyrtojnë rekomandimin për ndërprerjen e kontratës dhe në rast se vendosin për aprovimin e rekomandimit, ZPP menjëherë fillon procedurat për ndërprerjen e kontratës, duke e njoftuar kontraktorin për fillimin e procedurave dhe arsyet për ndërprerjen e kontratës.
- 72.4 Kontrata konsiderohet e ndërprerë kur Vendimi për ndërprerje i ZKA dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit bëhet i plotfuqishëm. Vendimi bëhet i plotëfuqishëm kur nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. Vendimi mbi ndërprerje të kontratës do të ngarkohet në platformën elektronike.

Neni 72A

Pranimi i furnizimeve, shërbimeve dhe punëve

72A.1. Pranimi i furnizimeve bëhet nga Komisioni për Pranimin e furnizimeve i cili emërohet me Vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Komisioni për Pranimin e furnizimeve ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblertjen.

72A.2. Komisioni për Pranimin e furnizimeve duhet të jetë në përbërje prej jo më pak se tre (3) anëtarë nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe menaxherin e kontratës. Nëse nuk ka ekspertë të tillë Brenda AK-së, AK do të angazhojë ekspert të jashtëm në përputhje me nenin 39.9 të kësaj rregulloreje.

72A.3. Pranimi i punëve bëhet nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës i cili ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së punëve të pranuar, të cilat dokumentohen me raport përfundimtar se janë në përputhshmëri me kontratën dhe specifikimet teknike.

72A.4. Pranimit i shërbimeve bëhet nga Menaxheri i Kontratës, apo Ekipi për Menaxhimin e Kontratës nëse i njëjti është emëruar. Menaxheri i Kontratës, apo Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së shërbimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me raport përfundimtar se janë në përputhshmëri me kontratën dhe specifikimet e kërkuara.

Neni 73

Përmbledhja e shënimeve të menaxhimit të kontratës

73.1 Autoritetet kontraktuese nëpërmjet menaxhereve të kontratës dhe sistemit të prokurimit elektronik do të mirëmbajnë një përmbledhje të shënimeve të menaxhimit të kontratës lidhur me çdo procedurë prokurimi që përmbanë::

- a) Dokumentin e nënshkruar të kontratës, përfshirë ndryshimet e nënshkruara të kontratës;
- b) Kopjen e planit për menaxhimin e kontratës;
- c) Urdhrat për variacion apo ndryshim të lëshuara nën kontratë;
- d) Dokumentet e kontratës lidhur me përmbushjen e obligimeve të kontratës, në veçanti letrat bankare me vlerë dhe garancionet e pagesave;
- e) Procesverbalet nga takimet lidhur me menaxhimin e kontratave, përfshirë progresin e kontratës apo takimet shqyrtuese;
- f) Dokumentet e dërgesave që evidentojnë dërgesën e furnizimeve apo çertifikatat e kompletimit në lidhje me një kontratë për shërbime apo punë;
- g) Kopjen e të gjitha faturave për punimet, shërbimet apo furnizimet përfshirë letrat e punës që verifikojnë saktësinë e pagesave të kërkuara dhe detajet e pagesave të kryera të autorizuara nga menaxheri i projektit;
- h) Kopjen e listave të pagesave që evidentojnë menaxhimin e të gjitha pagesave të kryera;
- i) Kopjen e kërkesave të bëra nga menaxheri i kontratës/projektit në emër të autoritetit kontraktues lidhur me kërkesat për garanci, jo-garanci, furnizim të pamjaftueshëm, dëmet dhe kërkesat tjera ndaj furnizuesit.

Neni 73A

Përmbyllja e kontratës

73A1 Pas përfundimit të të gjitha procedurave dhe veprimeve sipas neneve 72A dhe 73, bëhet përmbyllja e kontratës si në vijim:

- a) Për kontrata për punë apo për furnizime për të cilat në kontratë kërkohet periudha garantuuese, Menaxheri i Kontratës përgatitë dhe nënshkruan Certifikatën e Pranimit të Përkohshëm. Certifikata e Pranimit të Përkohshëm lëshohet jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas pranimit të mallrave apo punëve, sipas Nenit 72A të kësaj rregulloreje. Lëshimi i Certifikatës për

Pranimin e Përkohshëm i përmbyllë obligimet e palëve kontraktuese për fazën e ekzekutimit të kontratës.

- b) Për kontrata për furnizim për të cilat në kontratë nuk kërkohet periudha garantuese, Menaxheri i Kontratës përgatitë dhe nënshkruan raportin përfundimtar, duke u bazuar në procesverbalin e Komisionit për Pranimin e Mallrave. Me lëshimin e raportit përfundimtar nga Menaxheri i Kontratës, obligimet e palëve kontraktuese konsiderohen të përfunduara.
- c) Për kontrata për shërbime, me lëshimin e raportit përfundimtar nga Menaxheri i Kontratës, obligimet e palëve kontraktuese konsiderohen të përfunduara.

Neni 73B

Periudha garantuese dhe pranimi përfundimtar

73B1 Për kontrata për punë apo për furnizim për të cilat në kontratë kërkohet periudha garantuese, Menaxheri i Kontratës para lëshimit të Certifikatës së Pranimi të Përkohshëm kërkon nga kontraktuesi që të përgatisë dokumentin e garancisë për periudhën e përgjegjësisë për defekte, sipas specifikimeve të përcaktuara në kushtet e kontratës.

73B2 Menaxheri i Kontratës gjatë periudhës së përgjegjësisë për defekte do të identifikojë, inspektojë dhe vlerësojë të gjitha defektet në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar duke përfshirë raportet e detajuara, vlerësimin e shkallës së dëmtimit, fotografi etj. Menaxheri i Kontratës do të njoftojë kontraktuesin me kohë për defektet që kanë ndodhur dhe do të kërkojë që defektet të riparohen/eliminohen duke i dhënë një afat kohor të arsyeshëm. Kontraktuesi menjëherë pas marrjes së njoftimit duhet brenda afatit kohor të përcaktuar, me shpenzimet e veta të korrigjojë defektet, përfshirë riparimin, zëvendësimin ose rregullimin e çdo problemi që është konsideruar si defekt.

73B.3 Periudha e përgjegjësisë për defekte fillon nga data e lëshimit të Certifikatës për Pranimin e Përkohshëm, sipas kushteve të kontratës.

73B.4 Për çdo korrigjim të defekteve sipas paragrafit 73B.3, Menaxheri i Kontratës lëshon raport ku konstatohet se janë eliminuar defektet. Periudha e përgjegjësisë për defekte rifillon nga data e lëshimit të këtij raporti.

73B.5 Pas skadimit të periudhës së përgjegjësisë për defektet, si dhe pas korrigjimit të defekteve apo dëmeve të shfaqura, Menaxheri i Kontratës do të lëshojë kontraktuesit Certifikatën për Pranimin Përfundimtar.

Neni 74

Monitorimi i kontratës

74.1 Sipas nenit 81 të LPP-së, KRPP është përgjegjës për monitorimin e menaxhimit të Kontratës. Menaxhimi i kontratës fillon kur nënshkruhet kontrata dhe vazhdon deri pas skadimit të garancioneve.

74.2 KRPP do të monitorojë nëse kontrata është zbatuar në përputhje me kushtet e kontratës. Kontrata përkufizon qëllimin e kontratës, fushëveprimin, specifikacionin dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit/ Kontraktuesit/ Ofruesit të Shërbimeve. Kontrata detyron Autoritetin Kontraktues dhe Furnizuesin/Kontraktuesin/Ofruesin e Shërbimeve që t'i përkushtohen kontratës dhe obligimeve të tyre përkatëse.

74.3 KRPP do të fokusohet kryesisht në faktet nëse:

1. Çertifikatat e nënshkruara (çertifikatat e përkohshme/te përhershme) ishin lëshuar nga menaxheri i kontratës për dorëzimet;
2. Nëse dorëzimet nuk kanë qenë me kohë, a janë imponuar dëmet e likuiduara;
3. Kontrata është ndërprerë dhe është konfiskuar siguria e përformancës, nëse dëmet e likuiduara të imponuara kanë arritur kufirin maksimal të lejuar për dëmet e likuiduara;
4. Siguria e përformancës ishte dorëzuar, nëse është e zbatueshme;
5. Siguria e avansit ishte dorëzuar, nëse është e zbatueshme;
6. Polisa e sigurimit ishte dorëzuar, nëse është e zbatueshme;
7. Garancia për periudhën e përgjegjësisë së defekteve ishte dorëzuar, nëse e aplikueshme;
8. Pagesat janë bërë me kohë.

Neni 75

Ndarja e detyrave

75.1 "*Ndarja e detyrave*" do të thotë se autoriteti i një personi(ave) për të miratuar dhe për të nënshkruar miratimin në një fushë të përgjegjësisë. Disiplinat e specializuara të përgatitjes së kontratave (ligjore dhe teknike), zbatimit të kontratës dhe pagesave (faturat) duhet të mbahen si aktivitete të veçanta me miratimet e veçanta nënshkruese. Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Prokurimit dhe Njësia pranuese / Menaxheri i kontratës nuk mund të nënshkruajnë ndonjë dokumentacion jashtë fushës së tyre të përgjegjësisë.

75.2 Sipas ndarjes së detyrave, zyrtarët përgjegjës të departamentit mund të nënshkruajnë një dokument vetëm nëse është me origjinë nga vet departamenti i tyre. Asnjë departament nuk lejohet që të miratojë një dokument nga Departamentet tjera.

75.3 Parimet e ndarjes së detyrave janë si më poshtë dhe i japin autoritet vetëm personave të mëposhtëm (ose zëvendësi / ndihmësi i caktuar i atij departamenti) në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave që bëhet në emër të autoritetit kontraktues:

1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të nënshkruajë një kontratë, por është i ndaluar që të nënshkruajë pranimin e mallrave, artikujve të instaluar, përfundimin e një projekti, dorëzimin në faza, ose pagesën e një fature;
2. Zyrtari kryesor financiar duhet të nënshkruajë pagesën e faturës, ose dokumentet tjera të lidhura me të, por është i ndaluar që të nënshkruajë pranimin e mallrave, artikujve të instaluar, përfundimin e një projekti, dorëzimin në faza, ose Kontratën;
3. Njësia e pranimit, menaxheri i kontratës, inxhinieri do të nënshkruajë pranimin e mallrave, artikujve të instaluar, standardet e cilësisë, përfundimin e një projekti, dorëzimin në faza, por jo pagesën e një fature, apo Kontratën;
4. Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, mund të shërbejë si menaxher i kontratës por nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit .
5. Një OE i cili ka hartuar një projekt, mund të mbikëqyr të njëjtin projekt.
6. Një OE i cili ka hartuar një projekt nuk mund të ekzekutojë projektin (një procedurë e re duhet të iniciohet për kryerjen e punëve).
7. Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i kontratës, mirëpo në rast të ri-vlerësimit, anëtarët e komisionit të kaluar të vlerësimit mund të shërbejnë si menaxher të kontratës.




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0050004/25
Data 25.11.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Krjetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 81 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, konform nenit 70 paragrafi 70.17, 70.18, 70.19 dhe 70.20 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, pas shqyrtimit të kërkesës së DPP-së Nr.14-020/01-0049446/25, të datës 19.11.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

- I. Caktohet Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Ekipit për Menaxhimin e projektit / kontratës për tenderin me titull: **“048 – Ndërtimi i Zonave Rekreative në Skenderaj – Parku “Idriz Rreci”**, si vijon:
 1. znj. Sebahate Murseli Sylanaj – kryesuese e ekipit;
 - 1.1 z. Baki Beqiri – anëtar;
 - 1.2 znj. Valentina Hylanaj – anëtare.
 2. z. Hetem Dajaku, caktohet mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Ekipit për Menaxhimin e Kontratës sipas pikës I të këtij vendimi.
- II. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Ekipit për Menaxhimin e Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 70 paragrafi 70.17, 70.18, 70.19 dhe 70.20 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- DPP- së
- Anëtarëve
- Mbikëqyrësit

Kryetari i Komunës

Fadil Nura

